




Republika e Kosovës
Komuna e Malishevës



Drejtoria për Administratë dhe Personel
Zyra e Prokurimit
Nr 03/ 08
Datë 20/03/ 2020.

KONTRATË PROKURIMI Nr 05

Komuna e Malishevës (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë; dhe
Gani Kastrati B.I. (N.T.H. "BIMI") me seli në Malishevë me Nr.biznesi 810705056
(në vazhdim "Operatori Ekonomik"), ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontrate
publike për:

**FURNIZIM ME MATERIAL HIGJENIK PËR NEVOJAT E SHKOLLAVE
FILLORE DHE TË MESME TË KOMUNËS SË MALISHEVËS**
me numër identifikues: **62500.20.023.136**

Neni 1. Lënda

- 1.1 Lënda e kontratës do të jetë: FURNIZIM ME MATERIAL HIGJENIK PËR NEVOJAT E SHKOLLAVE FILLORE DHE TË MESME TË KOMUNËS SË MALISHEVËS.
- 1.2 Kontrata hynë në fuqi me rastin e nënshkrimit dhe përfundon me kryerjen e furnizimit me material higjenik për nevojat e shkollave fillore dhe të mesme të Komunës së Malishevës.
- 1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se [shëno numrin] ditë nga data e marrjes së urdhëreses.
- 1.4 Vendi i dërgimit të furnizimeve do të jetë: Nëpër shkollat Fillore dhe të Mesme të Komunës së Malishevës.
- 1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP² (Detyra e Dërguar e Paguar).

² DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

Neni 2. Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë Sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridikioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3. ÇMIMI

3.1 Çmimi total i kontratës është: **5,982.78€** (me shkronja) :

(**pesëmijëenëntëqindëtetëdhjetëedyeuroeshtatëdhjetëetetëcentë**).

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë maksimumi i pagesës (sipas sasis se planifikuar) që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtronet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës.

Neni 3.3. Menaxhimi i Kontratës

Menaxhimin e Kontratës furnizim me material higjenik për nevojat e shkollave fillore dhe të mesme të Komunës së Malishevës do ta e bëjë zyrtari i DKA-së **z. Enver Mazreku** i caktuar nga ZKA-ja e AK-së.

Neni 3.4 Obligimet e OE

Furnizim me material higjenik duhet të jenë në cilësi dhe sasi të kërkuar nga autoriteti kontraktues dhe në përputhëshmëri me specifikacionin e ofertës dhe me afatë të mjaftueshem të përdorimit. Nëse Furnizimi me material higjenik nuk janë në cilësi dhe sasi (sipas specifikacionit të ofertës) dhe me afatë te mjaftueshem të përdorimit do të i kthehen operatorit ekonomik dhe shpenzimet e bëra biejnë në llogari të operatorit ekonomik. Furnitorit do të i kthehen edhe material higjenik i dërguara pa porosi të kontraktuesit të parë.

Neni 3.4 Afati i furnizimit

Furnizim me material higjenik do të bëhet për **10 ditë** që nga dita e nënshkrimit të kontratës.

Neni 4. PAGESA

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Obligohet kontraktuesi i parë (AK) që pasi t'a pranon raportin e pranimit të furnizimit me barëra për raste sociale dhe faturën se nga kontraktuesi i dytë (OE), t'ia paguaj shumën sipas nen. 3 dhe 3.1 të kësaj kontrate.

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5. Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6. Kualiteti

6.1 Kualiteti i furnizimeve duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7. Garancioni

7.1 Garancioni do të mbetet valid për _____ muaj, pas pranimit të [furnizimeve] [shërbimeve] [punëve].

Neni 8. Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin [*t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat*] [*të realizojë ndonjë ose te gjitha shërbimet*] [*te kryej ndonjë ose te gjitha punët*] brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës

aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së **[furnizimeve]** të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9. Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshterinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshteria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10. Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontraktojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11. Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuginë e *res-judikata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtuar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korruption, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12. Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimesht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsy që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 . Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.



13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në [specifiko gjykatën kompetente] në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 14. Komunikimi


14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin ei identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhen **Shqipe** në katër origjinale, tri origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Nuhi Shalaj
Pozita:	Menagjer i Prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	20/03/2020
Vula:	

Për Operatorin Ekonomik

Emri:	Gani Kastrati
Pozita:	Drejtor
Nënshkrimi:	
Data:	20/03/2020
Vula:	

REPUBLIKA E KOSOVËS
DREJTORIA PËR ARSIM

SPECIFIKACIONI I MATERIALIT HIGJENIK NEPER SHKOLLAT FILLORE DHE TË MESME

Nr Rendi Pershkrimi	Njesia matedese	Sasia	Çimimi per njesi pa TVSH	TVSH (%)	Çimimi per njesi me TVSH	Çimimi total me TVSH
1 Tretësirë për pastrimin e gypave(nyjeve sanitare)	Copë	300	1,82	18%	2,145	643,50
2 Shampón për WC Net	L	530	1,86	18%	2,189	1160,17
3 Tretësirë për WC Pastrues (Dezinfektues)	Litër	610	1,39	18%	1,639	999,75
4 Dorëza plastike për një përdorim	Pako	45	3,96	18%	4,672	210,23
5 Shampón për duar	Copë	785	0,92	18%	1,055	854,87
6 Rolle XXL	Copë	689	0,93	18%	1,100	757,90
7 Detergjent tretësirë për pastrimin e dyshemeve prej materiali PVC Qeramike	copë	300	1,26	18%	1,490	447,00
8 Detergjent tretësirë adekuatë përlarjen e lavamaneve guacave	L	350	0,92	18%	1,089	381,45
9 Test Varikin 1000 ML	L	485	0,92	18%	1,089	528,17
T O T A L I						<u>5982,78</u>

